



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	27.02.2025
REFERENC-Ë:	24/3859/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"ISEFERI", Sh.p.k., Gjinoc, Suharekë Bazë për prodhimin e Betonit.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore, operatorit, "ISEFERI", Sh.p.k., Gjinoc, Suharekë, Nr. Prot.24/3859, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e Betonit.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

1. Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative për operatorin, "ISEFERI", Sh.p.k., Gjinoc, Suharekë,

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/3859/MMPHI
Datë: 27.02.2025


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatori, "ISEFERI", Sh.p.k., Gjinoc, Suharekë, i ndërpritet procedura administrative për pajisje me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: bazë për prodhimin e Betonit, në ngastrën, nr. 02785-36, nr.02785-37, zona kadastrale, Gjinoc, Suharekë.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "ISEFERI", Sh.p.k., Gjinoc, Suharekë, i ndërpritet procedura administrative për pajisje me Leje Mjedisore për veprimtarinë: bazë për prodhimin e Betonit, në ngastrën, nr. 02785-36, nr.02785-37, zona kadastrale, Gjinoc, Suharekë.



Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje Mjedisore ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka gjetur që dokumenti i lejes për aktivitete të veçanta nga KPMM, i ka skaduar afati. Pala ka bashkangjitur vetëm njoftimin nga KPMM, që dokumenti i lejes për aktivitet të veçante është ende në procese, dhe nuk ka përfunduar.

Komisioni për Leje Mjedisore në takimin e mbajtur të datës: dt. 19.08.2024, konstatoi se operatori, "ISEFERI", Sh.p.k., Gjinoc, Suharekë, për veprimtarinë: bazë për prodhimin e Betonit, nuk i plotëson kriteret e parapara, për pajisje me Leje Mjedisore, pasi që nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur më lartë në afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **mbyll procedurën administrative** në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Suharekë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.